




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr 201/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej z. Agon Ramadani- Kryetar, znj. Kimete Gashi- Anëtare si dhe znj. Nita Bejta- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “AS-TECH” SHPK-nga Prishtina, kundër njoftimit për dhënie të kontratë për aktiviteti e prokurimit: “Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale”, me nr. të prokurimit: 616-22-1994-1-2-1, nr. te brendshem:616 22 019 121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi i Komunës se Prishtinës, më datën: 05. 08. 2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “AS-TECH” SHPK-nga Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratë për aktiviteti e prokurimit: “Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale”, me nr. të prokurimit: 616-22-1994-1-2-1, nr. te brendshem:616 22 019 121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi i Komunës se Prishtinës.

- II. **ANULOHET** vendimi për dhënie të kontratës i autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale”, me nr. të prokurimit: 616-22-1994-1-2-1, nr. te brendshem:616 22 019 121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi i Komunës se Prishtinës dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.
- III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.
- V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues " AS-TECH" SHPK aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.
- VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues, “AS-TECH” SHPK-, si palë e pakënaqur më datën: 12. 06. 2022 ka parashtruar ankesë me numër 201/22, kundër vendimit për dhënie të kontratës: “Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave ne objektin e Komunës dhe institucioneve tjera Komunale”, me nr. të prokurimit: 616-22-1994-1-2-1, nr. te brendshem:616 22 019 121, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Kuvendi i Komunës se Prishtinës, duke pretenduar që AK ka vepruar në kundërshtim me:

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 7 – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi Rregullat për tenderin jo normalisht të ulët

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 14. 06. 2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 23. 06. 2022, në raportin e ekspertizës ka sqaruar se:

Përgjigje e pretendimet ankimore nr.1 për shkeljet e nenit 59 të LPP-se

Ky pretendim ankimor është i pabazuar sepse AK ka themeluar komision të vlerësimit të tenderëve, për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe ky komision edhe ka hartuar raportin e vlerësimit, dhe në bazë të këtij raporti edhe i është kërkuar sqarime shtese OE- me të lirë në këtë rast konform rregullave për tender jo-normalisht të ulët,

AK në këtë rast po ashtu ka respektuar edhe paragrafin 2 të nenit 59 të LPP-se duke i kërkuar sqarime OE- me të lirë përmes E-mailit dhe OE- brenda afatit ligjor i është përgjigjur kësaj kërkesë duke i dhënë sqarimet e nevojshme që për AK në këtë rast kanë qenë bindëse. Pretendimi ankimor është i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin e dytë ankimor për shkeljet e nenit 60 të LPP-se

Lidhur me shkeljet e nenit 60 të LPP-se Kriteret për dhënie të kontratës, në dosje të tenderit AK ka përcaktuar se kriter për dhënie të kontratës është Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët 1 i poentuar nga tenderuesit e përgjegjshëm e në rastin konkret OE- i propozuar për kontratë ka çmimin më të lirë të poentuar apo peshuar prandaj mendoj se ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin e tretë ankimor për shkeljet e nenit 7 të LPP-se barazia në trajtim/jo-diskriminimi Rregullat për tender jo-normalisht të ulët.

Edhe në këtë pikë mendoj se AK i ka zbatuar rregullat për tender jo-normalisht të ulët sepse edhe në nenin 1 të këtyre rregullave thuhet:

Qëllimi i këtyre Rregullave është që të jepen sqarime për Autoritetet Kontraktuese në lidhje me Konceptin e tenderit jo-normalisht të ulët i cili i referohet atyre tenderëve që, në shikim të parë,

duken për autoritetin kontraktues si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe, në përputhje me rrethanat, ka gjasa për një performancë të keqe të kontratës.

1.2 Në çdo rast, kur ka një prag për tender jo-normalisht të ulët, **ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo-normalisht të ulëta** pa përdorur një procedurë *inter partes* me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët

Ne këtë rast AK-ka zbatuar një procedurë *inter partes* duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja **"Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët"**. ku OE i është përgjigjur kësaj kërkesë për sqarime dhe AK është bindur në sqarimet e dhëna prandaj mendoj se edhe ky pretendim ankimor është i pabazuar.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna më lart), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues të OSHP-së që ankesa të refuzohet si e pabazuar. Autoriteti Kontraktues të vazhdon më tej me këtë procedurë.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 24 qershor 2022 me raportin e ekspertizës.

Operatori ekonomik ankues me 30 qershor 2022 me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues me 24 qershor 2022 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit të OSHP-së.

Seanca e shqyrtimit kryesor është mbajtur me datën: 01 gusht 2022, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për dhënie, kërkesa për rishqyrtim, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të jashtëm të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë seancës për shqyrtim kryesor përfaqësuesi i OE "AS TECH" SHPK z. Tarani deklaroj: "Me rastin e kërkesës për rishqyrtim të datës 29.05.2022 kemi marrë nga departamenti i prokurimit vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me të cilat në arsyetim janë të

paraqitura argumente AD Hoc te pa argumentuara prandaj duke ditur kompetencat dhe objektivat e OSHP për gjykimin e ofertave manipuluese ju kemi drejtuar ankesë për mes se cilës sot po mbajmë këtë gjykim.

Prandaj ne si OE jemi te pa kënaqur me mënyrën se si AK e ka vlerësuar ofertën e OE Sabri Azemi ne mënyrën se si janë pranuar çmime prej 1180% me te ulëta sesa çmimi i tregut dhe se si ja pranuar dokumente manipuluese te asaj oferte. Arsyetimi i OE nuk është aspak bindes për pozicionin nr. 8 Furnizim me kondicioner kanalor 65.000 / ftohje 60.000 BTU, çmimi i dhenë ne ofertë është 260 euro ndërsa ne treg çmimi i njëjte i furnizimit sillet prej 2500 euro deri ne 3070 euro varësisht a parashihet montimi apo jo.

Arsyetimi i OE është se ka pjesë rezervë për servisime prandaj edhe ka vendosur këtë çmimi te ulet, gjë qe kjo përgjigje është e pa papranueshme dhe s'ka te beje as me logjike por as me bazë ligjore sepse pozicionoi ka natyrën e furnizimit dhe nuk përfshihen pjesët për mirëmbajtje dhe servisim por ekskluzivisht ka te bej me furnizimin me paisje. OE çmimin e ulet prej 260 euro mundohet te arsyetoj me ofertën qe e ka marrë nga Install injiniering me 30% zbritje, gjë qe te njëjtën ofertë e kemi marrë edhe ne si OE por aty shkruan çmimi 3070 euro madje pa zbritje, por edhe nëse na ofron zbritje prej 30 % del çmimi prej 149 euro e jo 260 euro ashtu siç e ka dhënë arsyetimin.

Te njëjtat oferta i kemi marr edhe nga 3 furnizues te tjerë për ta paraqitur ne realitet çmimet e tregut te cilat i përshkruajmë: Furnizuesit ne

1. Install engineering çmimi i ofertës është 3070 euro
2. ACN Midea çmimi i ofertës është 2400 euro dhe
3. Enigma BB çmimi i ofertës është 2500 euro.

I njëjti pozicion ne ofertën ton kushton 2600 euro ndërsa ne ofertën e OE Sabri Azemi kushton 260 euro.

Konstatojmë se edhe ne ofertën nga Install engineering e ka manipuluar sepse ne ofertë shkruan vetëm një zbritje prej 30 % për persona privat dhe askund çmimi blerës ose i ofruar ne ofertën e OE te marrur nga Install engineering nuk figuron sa është çmimi blerës i klimës çka do te thotë se si ehte e mundur te ketë ofertë pa çmim apo ndoshta nuk guxohet te tregoj çmimin ofertues por vetëm një zbritje pre 30%. Arsyetimin për çmim me te ulëta si ne total te ofertës po ashtu për pozicion do te duhet te pranohen vetëm nëse e bindin komisionin se vërtet OE ka përparësi krahasuese ose llogari te oferton pe rate pozicion, ne këtë arsyetim askund nuk

shihet llogari e fitimit përveç humbje prej 800 %”.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Bajramaliu i cili deklaroj: “Unë me datën 14.06.2022 kam marr autorizimin.

Mbetem pranë raportit të ekspertizës që e kam dhënë të dorëzuar me datën 23.06.2022 ku kam propozuar PSH të OSHP që ankesa të refuzohet si pa bazuar dhe AK KK Prishtinë të vazhdojë me tej me këtë procedurë”.

Pyetjes se: “A keni bërë hulumtime të tregut”, Eksperti është deklaruar që “po”.

Pyetje për pozicionin nr 8 a mund të na informoni për çmimin tregut për artikullin përkatës Përgjigja nuk kom hulumtu tregun jashtë vetëm në rastin konkret jam koncentruar të sqarimet e kërkuara nga komuna e Prishtinës dhe sqarimet e dhëna nga OE i propozuar për kontratë Sabri Azemi BI duke i besuar edhe marrëveshjes të cilën e kanë lidhur këto dy OE dhe asaj që OE i propozuar ka pranuar të paguaj sigurimin e ekzekutimit me tepër se sa që është kërkuar në shumë prej 20 % të vlerës që në kushte normale kërkohet 10 %

Përgjigje un jam koncentru në marrëveshjen që e kanë bërë si OE dhe duke par atë që AK është bindur në këto sqarime e dhëna i kam propozuar panelit atë që është e theksuar në raport.

OE pyetje për ekspertin marrëveshja të cilën ja ke fal besimin e cila është në mes të Sabri Azemit dhe engineering që e ka të ceken vetëm një 30 % dhe nuk e ka çmimin blerës

A e keni par pozicionin nr 1 , 24, 25, dhe 26 të kësaj oferte çmimi në treg për pozicionin nr 24 në mbajtëset të njëjësishë se jashtë kushton 4 euro deri në 5 kurse OE i rekomanduar për kontratë e të çmimin 30 euro pozicioni nr 25 furnizim me gyp CU6 në treg kushton 2 e 90 për metër kurse OE e ka cek 30 euro për metër si dhe pozicioni nr 26 i njëjti gyp CU12 çmimi është në treg është 2 e 90 kurse e ka qit 35 euro e sugjerojmë ekspertin me kësaj lëndë që ta hulumtoj tregun për ta bër një ekspertizë adekuate profesionale dhe mos të shkoj copy paste siç ka thënë OE Sabri Azemi dhe AK KK Prishtinë.

AK ka dorëzuar përgjigje me shkrim ku kanë ofruar një Konstatim, si në vijim:

Baza ligjore faktike:

Autoriteti Kontraktues në bazë të nenit 42 të Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik si akt dytësor normativ që detajon Ligjin e Prokurimit Publik e cila thekson si në vijim: Referoju rregullave të aprovuara nga KRPP, të publikuara në web-faqen e KRPP-së, B57 "Rregullat për tenderët jo-normalisht të ulet".

Poashtu në bazë të nenit 39 par.1 të RRUOPP-së AK ka kërkuar nga OE sqarime të tenderit që lidhen me çmimet e cila thekson si në vijim:

39.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK "Kërkesë për sqarim të tenderit". Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike.

Poashtu duke u bazuar edhe në ekspertizën e ekspertit i cili ka konstatuar dhe mbështetur faktet ligjore bazike sipas vendimit të Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues konstaton se qëndron pranë vendimit të saj dhe mbështet ekspertizën e ekspertit me nr. 201/22.

Gjithashtu në çdo kohë dhe fazë është respektuar në tërësi neni 7 i LPP-së, neni 59. Andaj duke u bazuar në atë se çka u cek më lart i rekomandojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit në bazë të provave ligjore që të nxjerr:

- Vendim për Refuzim të mjetit juridik (ankesës) operatorit ekonomik ankimor As-Tech
- Të lë në fuqi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron;

Lidhur me procedurën e ndjekur nga Autoriteti Kontraktues “Kuvendi i Komunës së Prishtinës”, paneli vlerëson se nuk ka vërejtur shkelje procedurale të pretenduara nga Operatori Ankues sa i përket nenit 59 të LPP-së dhe se procedurat janë zhvilluar konform ligjit, që nga themelimi i komisionit për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve, ku ky komision edhe ka hartuar raportin e vlerësimit, dhe ne bazë të këtij raporti edhe i është kërkuar sqarime shtesë OE- më të lirë në këtë rast konform rregullave për tender jo-normalisht të ulët. AK në këtë rast po ashtu ka respektuar edhe paragrafin 2 të nenit 59 të LPP-se duke i kërkuar sqarime OE- më të lirë përmes postës elektronike dhe OE- brenda afatit ligjor i është përgjigjur kësaj kërkesë.

Sa i përket sqarimit ndaj kërkesës të AK për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, saktësisht mbi pozicionin 8- Furnizimi me kondicioner kanalor Ngrohje 65000/ Ftohje 60000 btu/h copë ku operatori ka ofertuar me çmim prej 260.00 €, OE ka sqaruar se posedon pjesë rezervë për servisimin e tyre si dhe ka bashkangjitur një marrëveshje me furnitorin “Install Engineering sh.p.k” ku potencohet se sipas kësaj marrëveshje OE N.SH Raketa për artikullin në të cilin referohemi ka zbritje prej 30% nga furnitori.

Paneli shqyrtues vlerëson se këto sqarime nuk janë mjaftueshëm bindëse konform Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët të KRPP-së, përkatësisht neneve 4.4 si dhe 4.5 duke mos ofruar shpjegim të mjaftueshëm konform pikave të këtyre rregullave, si në vijim:

- 4.4.1 *çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;*
- 4.4.2 *çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose*
- 4.5.1 *elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet.*

Lidhur me sqarimin e dhënë nga OE në fjalë, me të cilin deklaron se “posedon pjesë rezervë për servisimin e tyre” paneli konsideron se nuk përmban relevancë për rastin konkret sepse pozicioni nr 8, ka natyrë furnizimi dhe jo mirëmbajtjeje, kjo lehtë konstatohet nga vetë emërtimi i artikullit, që është “8- Furnizimi me kondicioner kanalor Ngrohje 65000/ Ftohje 60000 btu/h copë”

Gjithashtu duke ju referuar marrëveshjes së OE me furnitorin, paneli vlerëson se OE nuk ka ofruar sqarim të mjaftueshëm, sepse kjo marrëveshje nuk përmban çmimin e ofruar nga furnitori, por vetëm një zbritje prej 30%, që në krahasim me ofertat tjera të ofruara si dhe me hulumtime të thjeshta mbi çmimet e këtij lloji të kondicionerëve, bie ndesh me çmimin e tregut, duke marrë parasysh gjithashtu se pala ankuese ka ofruar ofertë nga i njëjti furnitor, përveç dy ofertave tjera ku çmimi për këtë artikull nga furnitori i njejtë (Install Engineering) është ofruar me vlerën 3070 euro, ndërsa dy të tjerat me vlerë prej 2400 dhe 2500 euro, e që në fund edhe nëse llogaritet zbritja prej 30 % me mesataren e çmimeve të tregut, çmimi i ofruar prej 260 euro del të jetë shumë më i ulët, andaj sqarimet e dhëna paneli shqyrtues i konsideron si jo të mjaftueshme gjithashtu duke mos mbështetur ekspertizën e ekspertit i cili gjatë seancës shqyrtuese në pyetjen e kryetarit të panelit, se a mendoni se çmimi prej 260 euro për këtë artikull është çmim tregu ?, eksperti deklaroi se: “nuk kam bërë hulumtim të tregut jashtë vetëm në rastin konkret jam koncentruar te sqarimet e kërkuara nga Komuna e Prishtinës”, e që Paneli konsideron se është ekspertizë jo e detajuar dhe e pamjaftueshme në aspektin hulumtues dhe sqarues.

Për më tepër, pas analizës, shqyrtimit si dhe krahasimit të tri ofertave të këtij aktiviteti, Paneli ka hasur në çmime të jo-kuptimta të ofruara nga OE i shpërblyer me kontratë, ku ky OE, në pjesët aksesore për montim dhe furnizim të klimës, siç janë: kabllot eletriike, furnizimet me gyp, mbajtësit e njësive të jashtme, që përbëjnë pozicionet me nr.; 13, 14, 24-28, ka ofruar çmime shumë të larta në krahasim me ofertat tjera si dhe çmimin e tregut, e që pas një përlllogaritje të një furnizimi, montimi dhe demontimi i klimave ekzistuese, me klimat e dhëna në paramasë, çmimi përfundimtar del të jetë më i lartë se ofertuesit tjerë, që paneli konsideron se bie ndesh me qëllimin e Rregullave për tenderët jo-normalisht të ulët, të cilat i referohen tenderëve që, në shikim të pare, duken për autoritetin kontraktues si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe, në përputhje me rrethanat, ka gjasa për një performancë të keqe të kontratës.

Andaj, duke u bazuar në faktet e gjetura si dhe sqarimet e dhëna, paneli shqyrtues ka vendosur që për këtë aktivitet të prokurimit, OE i rekomanduar për kontratë, Sabri Azemi B.I, **është i papërgjegjshëm.**

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryetar i PSH-së

Z. Agon Ramadani



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- KK Prishtinë

1x1 OE "AS Tech"

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.